



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 258/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala edhe Ferit Osmani anetare , duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Kamenicë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kamenicë, për shkak të vendosjes së posterave shenjat publike të trafikut për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega ne Kamenicë kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1000(njëmijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 14. 10. 2013 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga LVV, në të cilën theksohet se me datën 13 tetor 2013 ne rrugën Hodonoc – Domarovic në Kamenicë rreth orës 13:30 anëtarë të PDK-së kanë vendosur fotot e kandidatës për asamble komunale nga ky subjekt politik Malsore Kallaba në shenjat e komunikacionit publik. Sipas parashtruesit të ankesës subjekti politik PDK ka bërë të nenit 33 pika b) e LZP-së. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografimin si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 17.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 18.10.20, ora 12:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga PDK, në të cilën thekson se sipas të dhënave që kemi nga terreni personat e paautorizuar kane keqpërdorur posterin e kandidatës ne fjale duke e vendosur ne anën e pasme te shenjave te komunikacionit gje që edhe në këtë rast nuk është mbuluar shenja e komunikacionit. Andaj me të kuptuar këtë aktivistet e PDK-së kanë shkuar ne vendin e caktuar dhe e kane hequr posterin e kandidatës ne fjale nga shenjat e komunikacionit Bashkangjitur më përgjigjen në ankesë PDK, ka dërguar fotot me të cilën ka larguar posterat e kandidatës së saj nga shenjat e komunikacionit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të bashkangjitura shkresës së lëndës, shihet qartë se posterat e kandidatës për asamble komunale në Kamenicë nga radhët e PDK-së, janë të vendosura shenjat publike të trafikut e i cili veprim është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjekti politik PDK ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe faktin se posterat e kandidatës për asamble komunale në Kamenicë nga radhët e këtij subjekti politik kanë qenë të vendosura në vendin e palejuar për vendosjen e posterave . Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes, duke e larguar menjëherë posterin nga vendi ku ka ndodhur shkelja.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstaton se nga ana e subjektit politik PDK-së është shkelur neni 4 paragrafi 1 pika “b” të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe neni 33 pika b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatës për asamble të komunale nga PDK-së është i vendosur mbi shenjat publike të trafikut, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik PDK-së, për evitimin e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, në kuptim të neni 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it, neni 120 paragrafi 1 pika c), si dhe neni 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitja

Anr. 258/2013 më datën 25.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*